



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

# RAPORTI VJETOR 2015

MBI

## GJENDJA E DIGAVE DHE DAMBAVE

Qershor 2016

## Të përgjithshme

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), gjatë vitit 2015 ka punuar simbas programit të miratuar, të hartuar në mbështetje të kuadrit ligjor për sigurinë e digave e dambave në vend. Ka marrë në shqyrtim projektet e paraqitura, ka ndjekur propozimet e bëra për rastet që ka qenë e nevojshme të bëhen studime për saktësim të gjëndjes, si dhe ka marrë pjesë në grupet e hartimit të procedurave për programet e venjes për herë të parë në ngarkesë të objekteve të reja.

KKDM ka vazhduar të detajoje dhe adaptojë në kushtet reale, propozimin për hartimin e zbatimin e një programi kombëtar për sigurinë e digave, kjo në vijim të cështjeve të trajtuar në raporin vjetor të vitit 2014 dhe të dërguar organeve përkatëse nga KKDM.

### I. Ndër aktivitetet kryesore gjatë vitit 2015 kanë qenë :

- Shqyrtimi e miratimi i projekt-zbatimit të digës së Fangut për H/C me të njejtin emër mbi lumin Fan të Mirditës.
- Ndjekja dhe zgjidhja e emergjencës për digën e Manskurisë në Golem të Kavajës.
- Shqyrtimi i masave të propozuara nga KESH-i, lidhur me filtrimet e vërejtura në anën e poshtëme të digës së Komanit.
- Kryerja e kontrollit lidhur me praktikën dhe dokumentacionin për digën e Liqenit Artificial. Kontroll i kryer pranë Bashkisë Tiranë.
- Kontrolli në objekt dhe ndjekja e gjithë procedurave teknike e ligjore që kanë qenë të nevojshme për lëshimin e autorizimit për mbushjen për herë të parë të rezervuarit të H/C të Banjës.
- Asistencë teknike në terren në rastin e përmbytjeve dhe dëmtimit të argjinaturave në Cermet të Lushnjës.
- Mbledhje me përfaqësuesit e bordeve të kullimit për sensibilizimin lidhur me zbatimin e ligjshmërisë në fushën e sigurisë për digat.
- Informim të vazhdueshëm në nivele të larta të problematikës si dhe kujtesë e vazhdueshme për pronarët dhe shfrytëzuesit e digave e dambave për tërheqjen e vëmendjes në situatat e kërkua nga kushtet hidrometeorologjike.
- Plotësimi i librarisë së KKDM-së me të gjitha Buletinet e ICOLD-it.

- Pjesëmarrja në Kongresin e ICOLD-it në Stavanger, Norvegji, nga KESH-i.

## II. Digat në sektorin e Bujqësisë.

Në raportin vjetor të dërguar nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrale bëhet fjalë kryesisht për mundësите që kanë qenë në investime për riparimin e shumë digave që paraqesin problem në vite. Numri i tyre ka qenë dhe ngelet i lartë, si rrjedhojë dhe problemet po ashtu.

Gjate vitit 2015 kjo ministri, nëpërmjet një projekti të Bankës Botërore ka realizuar investimet për përmirësimin e gjendjes në 11 diga të rezervuarëve të cilat janë konsideruar si më të nevojshme për interes të bujqësisë. Ky projekt ka një vlerë prej rreth 900 milionë lekë. Gjithashtu janë kryer punime riparimi dhe në 10 diga të tjera, punime të kryera këto me fondet e investimeve nga buxheti i vetë MBZHRAU-se.

Në raportet e vitit 2014 rezultonin rreth 410 diga me problem dëmtimi në trupin ose veprat anekse të tyre (këtu përfshihen të 626 digat për ujtje pamvarësish nga administrimi nga pushteti vendor apo MBZHRAU. Në këtë kontekst numri prej 21 digash kundrejt 410 është shume i vogël. Këtë situatë e konsiderojmë shqetësuese për vetë faktin se kjo ministri ka patur dhe struktura e staf me experiençë edhe të trashëguar për kontrollin e monitorimin e digave, staf i cili konsiderohet i aftë për të parashtruar gjendjen dhe problematikat e lidhura me të, dhe nevojnë e marrjes së masave. Në raport theksohet se ish Bordet e Kullimit kanë kërkuar herë mbas here projekte dhe financime për ndërhyrje rehabilituese për të shhangur tregjet e mundëshme dhe për të vënë në eficencë kapacitetet e plota për ujitje, por për mungesë financimesh ato nuk janë realizuar.

Sa me sipër ngelet dicka që i takon së kaluarës, mbasi me dy vendime VKM Nr.567 dt. 14.07.2010 dhe VKM Nr.1108 dt. 30.12.2015, njëherë 315 dhe herën e dytë 305 rezervuarë dhe digat e anekset përkatëse kanë kaluar e po kalojnë në pronësi e administrim të pushtetit vendor, pra bashkive përkatëse simbas zonave që i takojnë. Ky kalim, për momentin paraqitet i dyzuar. Nga njëra anë duke menduar se pushteti vendor dhe komuniteti lokal do jetë me i lehtësuar në procedura për shfrytëzimin e këtyre veprave dhe vënien në përdorim të kapaciteteve ujore për zhvillime të

ndryshme ekonomike, do mund të krijohen më tepër premissa dhe për riparimin, vënien në eficencë të tyre dhe rrjedhimisht dhe problemet që lidhen me rritjen e interesit dhe sigurisë. Nga ana tjetër do duhet të mendojmë se në aspektin e sigurisë së digave do jemi shumë më të ekspozuar ndaj rrezikut. Kemi parasysh faktin se MBZHRAU, simbas ligjit kishte një grup të sigurisë së digave në ministri, i cili aplikonte dhe përgjithësonte praktikën e veprimit në të gjithë vendin dhe kjo realizohej nëpërmjet specialisteve që bënин pjesë në njësitet e drejtimit teknik që bënин pjesë në Bordet e Kullimit. Aktualisht specialistët e njësive të drejtimit teknik do kalojnë në bashkitë përkatëse, ndërsa mbeten për tu zgjidhur se cila ministri do jetë dhe do ketë grupin e sigurisë së digave për të gjitha ato diga që do janë pronë dhe shfrytëzohen nga bashkitë. Ekzistenza e një grupei specialistesh në nivelin e gjithë territorit është një kërkesë e legjislacionit për sigurinë e digave dhe që shërben për unifikimin e masave që do duhet të merren e të zgjidhen nga trajtimi në nivel kombëtar.

KKDM vec sa më sipër do rekomandonte që edhe procedurat e kalimit të pronësisë të zhvillohen brënda një afati kohor të caktuar dhe në përputhje me të gjithë rregullat e inventarizimit në mënyrë që mos kemi raste nga ato që mund të janë me të këqiat që të kemi objekte pa "zot" dhe të diskutohen shërbimet e vrojtimit e marrjes së masave për uljen e riskut nga këto objekte. Sugerojmë që ministritë që janë të ngarkuara për realizimin e këtij kalimi të mund të ndërhyjnë për kryerjen e tij simbas procedurave zyrtare dhe në një kohe sa më të reduktuar.

KKDM, mendon se do jetë e nevojshme një kohë që problemet e sigurisë së digave të bëhen të qarta dhe në administratën e bashkive përkatëse. Një ministri do duhet të ndjekë ndoshta plotësimin e strukturave me personelin përkatës, specialitetin e tyre e kjo duke patur parasysh dhe problemin e ndrrimit cdo katër vjet të administratës vendore.

Si përfundim do theksonim dhe një herë sa të rëndësishme janë problemet e kalimit të pronësisë, problemin e kompletimit të njësive të drejtimit teknik në cdo bashki dhe problemin e grupit të sigurisë së digave që do duhet të funksionojë në një nga ministritë për të gjitha digat që do të janë në administrim të pushtetit vendor i cili edhe vetë është duke u riorganizuar me reformën territorial.

### **III. Digat e Bashkisë Tiranë.**

Bashkia e Tiranes ka dërguar raportin vjetor për vitin 2015 për dy digat që ka në pronësi të saj, digën e Liqenit Artificial të Tiranës dhe digën e Bovillës, të dy këto diga vrojtohen nga Shoqëria e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë.

### Diga e Liqenit Artificial të Tiranës.

Historiku i kësaj dige është i njohur si dhe problemet që mbart kjo digë.

Shkurt përbledhim : Ndërtuar në vitin 1957-1958, është mbingritur mbas dy vjetësh, ka pase një numur rrëshqitjesh nga vitet 60 ne ato 90, në vitin 1999 është ribërë projekti nga ISP Hidroteknike dhe në vitin 2000 është bë rikonstruksioni i saj. Nga viti 2002 ka pasur problem funksionimin e portave të shkarkuesit fundor të saj.

Nga raporti vjetor i dërguar rezulton se Bashkia Tiranë me vendimin nr. 35, dt. 03.09.2015 të Këshillit Bashkiak ka kaluar digën në administrim të Shoqërisë së Ujësjelles-Kanalizimeve Tirane. Në raportin e kësaj shoqërie, jepen pak të dhëna lidhur me problematikën e digës. Kjo për arsyen edhe për periudhën e shkurtër që u morr në dorëzim nga kjo shoqëri por edhe nga mungesa e administritit në vazhdimësi të digës. Në raport me shumë përmenden të dhënat nga vrojtimet vizuale se sa ato do duhej të mateshin dhe nga ato që përbëjnë një problem të vazhdueshem e të trasheguar në këtë digë. Vazhdon të pretendohet nga Ujësjellës- Kanalizimet se nuk gjenden projektet e digës.

KKDM duke vlerësuar rëndësine e sigurisë së kësaj dige, ushtroj një kontroll për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë e digës në datë 20 Maj 2015. Nga kontrolli rezultuan mungesa që fillojnë, nga projektet e saj në bashki, mosfunksionimi i shkarkuesit fundor prej vitit 2002, vështirësitetë në kanalin e shkarkimit nga diga deri në lumin e Lanës, mungesa e një plani alarmi e evakuimi në rast avarie, si dhe mungesa e njësisë së drejtimit teknik në digë. Konkluzionet e kontrollit ju dërguan Bashkisë dhe ju rikujtuan zyrtarisht edhe mbas ndërimit të administratës mbas zgjedhjeve të qershorit 2015. Aktualisht, administrimi i digës i ka kaluar Shoqërisë së Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, e cila ka një njësi drejtimi teknik për digën e Bovillës, por nga raporti vjetor rezulton se problemet janë akoma për këtë digë. Diga, vec difekteve në shkarkuesin fundor, akoma nuk ka një plan alarmi e evakuimi simbas kërkeseve të legjislacionit për digat dhe dambat.

KKDM është shprehur gjithmonë e gatëshme për të ndihmuar në stabilizimin e gjendjes nëpërmjet verifikimit të zbatimit të ligjshmërise por puna konkrete dhe përgjegjesia e veprimeve është e pronarit dhe shfrytezuesit të digës, Bashkia Tiranë

dhe Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë. Këto institucione disponojnë fondet dhe burimet njerëzore për plotësimin e kërkesave ligjore të sigurisë.

KKDM për problemet e sigurisë lidhur me digën e Liqenit Artificial të Tiranës, i rekomandon Këshillit të Ministrave dhe Bashkisë Tiranë që të ndërmarrë një studim dhe projekt për kryerjen e punimeve që do konsiderohen të domosdoshme për sigurinë e kësaj dige. Ky projekt do duhet të trajtojë në rradhë të parë vënien në eficencë të shkarkuesit të rezervuarit dhe lidhur direkt me këtë edhe problemin e largimit të ujit nga diga e deri në lumin e Lanës. KKDM do vazhdojë të kërkojë Bashkisë Tiranë plotësimin e kërkesave për sigurinë e kësaj dige.

### Diga e Bovillës Tiranë.

Kjo digë është ndërtuar në vitin 1998. Funksionin kryesor e ka për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës. Ka një kapacitet rezervuari me rreth 20 milionë m<sup>3</sup> ujë.

Edhe kjo digë monitorohet po nga Shoqëria e Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë. Materiali i raportit vjetor që lidhet me monitorimin e kësaj dige është i kënaqshëmAty përshkruhen dhe njëkohësisht jepen shumë nga rezultatet e vrojtimeve të kryera nga njësia e drejtimit teknik të digës. Tashmë kjo njësi ka krijuar një traditë në rregullin e vrojtimit të kësaj dige. Nga raporti rezulton se gjëndja e digës është e kënaqëshme dhe nuk ka problem që të krijojnë shqetësim në moment. I vetmi problem sot për sot paraqitet mbajtja nën kontroll e rrëshqitjes që është e pozicionuar në anën perendimore të rezervuarit. Kjo nuk paraqet lëvizje të ndryshueshme por vazhdon me ritmin e saj të zakonshëm me një avancim të ngadalë drejt liqenit. Vrojtimi i saj do duhet të jetë me i shpeshtë në periudhën e shirave dhe vecanërisht kur ato mund të vazhdojnë për një periudhe të gjatë. Pamvarësish se është kryer një studim para disa vitesh ne do i rekomandonim Bashkisë Tiranë që për këtë treshqitje të kryhet një studim azhornues dhe të bëhet vlerësimi i gjëndjes së sotme si dhe marrja e masava që do të rekomandohen si efektive ose edhe lehtësuese. Gjykojmë kështu se pamvaresisht se aktualisht nuk kemi kërcenim por vete fakti se levizja vazhdon, ka mundësi që në një situatë të vecantë (termeti, p.sh) mund të kemi dhe pasoja të pa dëshirueshme.

Nga ana tjeter në raport duket se është treguar kujdes për mirëmbajtjen dhe funksionimin e mekanizmave në shërbim të shkarkimit të ujit, faktorë që kanë të bëjnë me gadishmërinë në rast situatash të vështira nga ana hidrometeorologjike.

Ashtu si theksuam për digën e Liqenit Artificial te Tiranës edhe për digën e Bovillës është e domosdoshme që të hartohet plani i alarmit dhe evakuimit të popullsisë. Këto plane ndërtohen mbi bazën e kërkesave që janë për llogaritjet në VKM nr.147, dt. 18.03.2004 për “Rregulloren e sigurisë së digave e dambave” Bashkia e Tiranës duhet ta ketë prioritet ndjekjen dhe hartimin e planit të alarmit e evakuimit për këto diga, kjo në përputhje me kërkesat e nenit 4 të rregullores së sipërcituar. Për sa me sipër Bashkisë Tiranë do i bëhet dhe një kujtesë e vecantë.

#### IV. Digat në sektorin e energjitikës.

Aktualisht këto janë digat e ndërtuara në Lumin Drin që administrohen nga KESH-i dhe në lumin e Matit dhe atë të Bistricës të cilat janë në administrim të shoqërisë private KURUM.

Ndërtimi i tyre ka bër të mundur krijimin e ujëmbledhësve të mëdhenj dhe ndërtimin e HEC –eve përkatës, përmes shfrytëzimit të cilëve sigurohet një fuqi e instaluar prej afro 1600 MGË. Një pjesë e këtyre digave sidomos digat e ndërtuara në lumin Drin administrohen nga kompani publike si KESH-i sh.a të cilat kanë ngritur struktura të posacme për monitorimin e tyre.

Këto Diga janë konsideruar si digat më të rëndësishme për vetë karakteristikat e tyre, lartësitë e tyre, rreziqet që mund të sjellin në rastet e ndonjë dëmtimi si dhe ndikimin e madh në ekonomi dhe mjedis.

Për këto arsy, këto diga janë trajtuar me shumë kujdes në drejtim të monitorimit të tyre dhe kontrolleve për sigurinë dhe shfrytëzimin e tyre.

Një pjesë e këtyre digave sidomos digat e ndërtuara në lumin Drin administrohen nga kompani publike si KESH sh.a të cilat kanë ngritur struktura të posacme për monitorimin e tyre.

Duhet theksuar se pamvarësish nga modernizimi i sistemeve të monitorimit dhe kontrollit të digave, faktori njeri me aftësitet profesionale dhe organizimet përkatëse ka një rol kryesor përmes vendimarrjeve të drejta dhe në kohën e duhur.

KKDM në cdo rast ka qëndruar pranë të gjithë shfrytëzuesve të digave për dhënien e ndihmesës dhe këshillave teknike dhe me rolin e saj ka punuar për zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi për rritjen e garancisë së sigurisë së këtyre digave (Ligji nr.8681, datë

02.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave" dhe VKM nr.147, dt. 18.03.2004, "Regullores për sigurinë e digave e dambave").

### Digat e administruara nga KESH-i.

Aktualisht mbi lumin Drin janë në shfrytëzim diga e HEC Fierzë, Diga e HEC Koman, Digat e HEC Vau i Dejës (digat e Qyrsaqit, Rragamit dhe Zadejës). Këto diga administrohen nga kompania publike KESH sh.a e cila ka ngritur struktura të posacme për monitorimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Gjatë vitit 2015 është vënë re se KESH sh.a ka kryer një punë me nivel profesional në drejtim të monitorimit të tyre si dhe të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të tyre.

Konkretilisht, KESH sh.a për herë të parë gjatë vitit 2015 ka kryer survejimin batimetrik të liqeneve të krijuara nga këto diga, modelimin hidrologjik të pellgut ujëmbledhës të kaskadës së lumbit Drin si dhe një studim në lidhje me analizën e riskut të këtyre digave në raste të ndonje prishje të mundshme të tyre.

Gjithashtu, KESH sh.a gjatë vitit 2015 ka realizuar një administrim mjaft të mirë të prurjeve të ardhura në të tre rezervuarët duke shmangur në maksimum shkarkimet në periudhat e prurjeve të mëdha. Ky admnistrim është bazuar në respektimin me rigorozitet të Rregullores së Shkarkimit të Plotave të miratuar në vitin 1998 nga Ministrat e Ndërtimit dhe të Energijsë. Duhet theksuar se në bazë të studimeve të fundit të realizuara nga KESH sh.a si dhe nga ekspertë të fushës rezulton se ka ardhur koha që kjo rregullore të rishikohet dhe të përditesohet në kushtet e reja dhe në përputhje me standartet e reja teknike të rekomanduara nga ICOLD-i.

Gjatë vitit 2015, KESH sh.a ka ndërmarrë insiativën e hartimit të planeve të veprimit në raste emergjente për shkak të prishjes së mundshme të digave dhe ka raportuar se me financimin e Bankës Botërore janë përfunduar këto plane ku janë përfshirë edhe hartat e përblyjeve në rastet e 5 skenarëve të ndryshëm të dëmtimit të digave të kaskadës së lumbit Drin. KESH sh.a raporton se këto janë bërë me konsulence të firmës spanjolle GNFE. Hartat e përblyjeve janë bërë për rastet e shkarkimit të plotave që mund të ndodhin një herë në 20 vjet, një herë në 100 vjet dhe një herë në 1000 vjet. KKDM në përputhje me Rregulloren për Sigurinë e Digave dhe udhëzimin

Nr.248 , datë 22.01.2000 ka kërkuar nga KESH sh.a të sjellë për miratim planet e veprimit në raste emergjente së bashku me hartat përkatëse të përmbytjeve për tu miratuar dhe të procedohet me shpërndarjen e tyre në institucionet përkatëse për njohje dhe zbatim. Megjithëse ka qenë gjithmonë kushti ligjor për hartimin e Planeve të Alarmit dhe Evakuimit, ky kusht nuk ka qenë i plotësuar as në digat më të rëndësishme e jo më në ato më të voglat. KKDM-ja prej një viti po punon vazhdimisht si për projektet e reja dhe ato ekzistuese të paisen me Planet e Alarmit dhe Evakuimit.

Me poshtë po japim një informacion më të detajuar në lidhje me seicilën prej këtyre digave:

- **Diga e HEC Fierzë**

Gjate vitit 2015, kjo digë ka qenë brenda të gjitha normave të sigurisë të parashikuara. Gjithashtu, gjatë shkarkimeve në fillimin e vitit 2015 nuk ka patur asnjë problem tek kanali i daljes së ujit apo shpatet anësore të digës. KESH sh.a vazhdon të kryeje me korrektsi dhe seriozitet, monitorimin gjeodezik, gjeologjik, sismik dhe hidroteknik të gjithë zonës së digës së Fierzës duke përfshirë edhe masivet gjeologjike me trezik rrëshqitje të Poravës dhe të Gropajt. Të dy këto masive rezultojnë të janë në gjendje relativisht të stabilizuar.

Vepra e marrjes është në funksion të plotë dhe brenda normave të projektimit dhe të shfrytëzimit. Të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike janë në gadishmëri. Galeria e kontrollit dhe cimentimit paraqitet pa probleme. Filtrimet në pjesë të veçanta të saj janë shumë të vogla dhe nuk vërehen shtime të sasisë së ujit. Sistemi i shkarkimit të HEC Fierzë (Shkarkuesi Nr. 3 dhe Nr.4) i nënshtrohen mirëmbajtjes periodike dhe remonteve profilaktike.

Në tetor 2015, në zbatim të rregullores së shkarkimit të plotave dhe Rregullores së përgjithshme të punës së KESH sh.a është kryer kontrolli teknik i tuneleve të shkarkimit Nr.3 dhe Nr.4. Gjatë këtij kontrolli është vërejtur se në Tunelin e shkarkimit Nr. 3, situata aktuale është normale.

Duhet theksuar se provat me ngarkesë të portave të punës të tunelit të shkarkimit Nr. 3 nuk janë kryer duke qenë se këto porta në bazë të Rregullores së shkarkimit të plotave pika 3.5 duhet të hapen pas marrjes së mendimit të Komisionit të Posacëm i cili mund të vendosë duke u bazuar në situatën hidrologjike. Porta e punës së tunelit të shkarkimit Nr.3 nuk është hapur që prej vitit 1990 si për arsyet e faktoreve hidrologjike ashtu edhe për arsyet e disa problemeve teknike të vërejtura në vitet e

kaluara. KKDM gjykon se kjo situatë nuk mund të vazhdojë e tillë dhe përfaktin se argumenti i mos hapjes do vazhdojë të rritet në funksion të faktorit kohë. KESH-i duhet të rrisë monitorimin në shërbim të situatave emergjente për këtë tunel dhe të punojë përgatitjen e zgjidhjeve të mundëshme që lidhen me tunelin e shkarkimit nr.3.

KESH sh.a informon se në kuadër të projektit të Sigurisë së Digave të financuar nga Banka Botërore, ka përfunduar projekti për rehabilitimin e shkarkuesve ekzistues dhe është në proces tenderimi zbatimi i këtij projekti.

Gjithashtu, në bazë të studimeve të kryera nga KESH në lidhje me hidrologjine e pellgut ujëmbledhës të lumit Drin, me anë të konsulenteve të huaj me përvojë në fushën e sigurisë së digave si dhe të kushteve aktuale, rezulton se është e nevojshme rritja e kapaciteteve shtesë të shkarkimeve në HEC Fierzë.

## Diga e Komanit

Gjatë vitit 2015, në këtë digë kanë vazhduar të kryhen punimet për rehabilitimin e pjesës së poshtme të saj në kuadër të projektit të sigurisë së digave të financuar nga Banka Botërore. Gjithashtu, KESH sh.a po kryen punime rehabilitimi edhe në kurorën e digës me synim përmiresimin e kushteve dhe rritjen e sigurisë së kësaj digë. Këto punime parashikohen të përfundojnë në vitin 2016.

Një problem i evidentuar që në fillim të vitit 2015 nga specialstët e KESH sh.a është problemi i evidentimit te filtrimeve te medha ne pjesen e poshtme te diges. KESH sh.a ka organizuar vrojtime te vecanta për sasinë e këtyre filtrimeve dhe origjinën e tyre. Në mars 2015, janë kryer konsultime me eksperte vendas dhe të huaj të sektorit të digave në bazë të cilave u arrit në përfundim se këto filtrime duhet të monitorohen me kujdes të vecante dhe në bazë të një programi pune të detajuar dhe profesional.

Brënda muajit Prill 2015, KESH sh.a hartoi programin e punës dhe organizoi punën me specialistet e tij në lidhje me monitorimin e sasisë dhe cilësise së këtyre ujrave si dhe ndërmorri një sërë studime dhe analiza për të përcaktuar origjinën e këtyre ujrave. Bazuar në studimet hidrokimike dhe gjeofizike të kryera gjatë vitit 2015, rezulton se këto ujra janë me origjine nga liqeni që dalin ne pjesen e poshtme te diges, kryesisht prej te dy shpateve ku mbështetet diga. Nga matjet e kryera ka rezultuar se sasia e ketyre filtrimeve prej 900 – 1000 l/sek eshte me luhatje shume te vogla gjate vitit ndersa turbullsia e tyre eshte mjaft e ulet.

Per vete rendesine e kesaj problematike, KESH sh.a po zbaton nje program masash i cili eshte miratuar ne KKDM dhe i konsultuar me eksperte te fushes. KKDM ka kerkuar raportim te herepashershem te zbatimit te ketij programi si dhe per vleresimin e situates dhe gjetjen e zgjidhjeve te duhura per zvogelimin dhe sistemimin e ketyre filtrimeve

Gjithashtu, nje problematike tjeter qe eshte duke u monitoruar nga KESH sh.a jane edhe rrjedhjet dhe filtrimet ne tunelin nr.3 te shkarkimit. Nga portat e punes tek tuneli nr.3 i shkarkimit per shkak te difekteve te eaterstopeve te ketyre portave ka rrjedhje te medha te cilat duhet te eliminohen sa me shpejt. Sipas KESH sh.a, ne kuader te projektit te sigurise se digave eshte hartuar projekti per rehabilitimin e shkarkuesve ekzistues ku pjese perberesee ketij projekti eshte edhe rehabilitimi i eaterstopeve te kesaj porte.

Nje problem tjeter qe monitorohet ne kete dige jane edhe rreshqitjet dhe carjet e shkembinjve ne shpatet e diges si dhe monitorimi i masivit te koluvioneve qe ndodhet ndermjet nderteses se centralit dhe kullave te ekuilibrit. Ne keto zona jane instaluar pajisjet perkatese te monitorimit te cilat tregojne se levizjet ne keto zona jane shume te vogla. Nje problem qe eshte zgjidhur gjate ketij vitit, ka qene rreshqitjet ne shpatet e pjeses se poshtme te diges se Komanit

Vepra e marrjes eshtë në funksion të plotë dhe brenda normave të projektimit dhe të shfrytëzimit. Të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike janë në gadishmëri. Galeria e kontrollit dhe çimentimit paraqitet pa probleme. Sistemi i shkarkimit te HEC Koman (Shkarkuesi Nr. 3 dhe Nr.4) i nenshtrohen mirëmbajtjes periodike dhe remonteve profilaktike.

Gjithashtu, ne baze te studimeve te kryera nga KESH ne lidhje me hidrologjine e pellgut ujembledhes te lumbit Drin, me ane te konsulenteve te huaj me pervoje ne fushen e sigurise se digave si dhe te kushteve aktuale, rezulton se eshte e nevojshme rritja e kapaciteteve shtese te shkarkimeve ne HEC Koman. Per keto ne kohen e duhur do duhet te hartohen dhe miratohen projektet perkatese.

KESH sh.a ka marre masa edhe per zvogelimin e prurjeve te ngurta anesore ne ligenin e Komanit si dhe evadimin e nje pjese te tyre nga ky ligen per te bere te mundur nje funksionim sa me te mire te kaskades.

**Digat e HEC-it të Vaut të Dejës.**

Për krijimin e liqenit te HEC Vau i Dejes janë ndërtuar 4 diga që janë diga e Qyrsaqt, Zadejes, Rragamit dhe Gjocaj. Tre të parat që administrohen nga KESH sh.a janë diga të mëdha ndërsa diga e Gjocajt më lartësi 12 m është administruar nga Ministria e Bujqësisë. Nga kjo digë merren arfro 2 m<sup>3</sup>/sek për vaditjen e zonës së mbishkodrës.

Digat e HEC Vau i Dejes që administrohen nga KESH sh.a janë në gjëndje të mirë dhe brënda normave të sigurisë të parashikuara në standartet teknikë dhe në rekomandimet e ICOLD.

KESH sh.a vazhdon të kryeje me korrektësi dhe seriozitet, monitorimin gjeodezik, gjeologjik, sizmik dhe hidroteknik të 3 digave të mësipërme. Nga ky monitorim rezulton se diga e Rragamit vazhdon të ketë probleme në lidhje me nivelin e lartë të ujrale nëntokësore. Për zgjidhjen e këtij problemi, KESH sh.a ka hartuar një projekt i cili pritet të zbatohet gjatë vitit 2016.

Gjithashtu, sipas raportit vjetor te KESH sh.a janë verejtur demtime ne pjesen e poshtme te diges se Qyrsaqt dhe Zadejes per te cilat po merren masat e duhura mbrojtse.

Në digat e Qyrsaqt dhe Zadejes në përgjithësi nuk ka probleme në lidhje me sigurinë e digave. Për rritjen e sigurisë së digës në Qyrsaq rezulton e nevojshme vëndosja e portave të remontit tek shkarkuesit sipërfaqesorë. Këto porta nuk janë vendosur që nga koha e ndërtimit të tyre dhe aktualisht ne bazë të projektit të sigurisë së digave është parashikuar vendosja e tyre dhe rehabilitimi i shkarkuesve ekzistues në digën e Qyrsaqt.

Vepra e marrjes është në funksion të plotë dhe brenda normave të projektimit dhe të shfrytëzimit. Të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike janë në gadishmëri. Sistemi i shkarkimit te HEC Vau i Dejes i nënshtronë mirëmbajtjes periodike dhe remonteve profilaktike.

Gjatë inspektimeve të kryera nga specialistet e KESH sh.a në tunelin e Digës së Zadejës në shtator 2015 janë vërejtur dëmtime të vogla të mureve anësore. Tabani i këtij tuneli nuk mund të kontrollohet pasi niveli i lartë i detyruar për shkak të ndërtimit të HEC Ashtës nuk lejon inspektimin e kësaj zone.

## Digat e administruara nga shoqëria KURUM

Nga raporti vjetor i paraqitur rezulton se si diga e Ulzës dhe ajo e Shkopetit janë brënda parametrave normal të punës. Janë montuar aparatura vrojtimi dhe matjet kryhen nga personel i ngarkuar posaçërisht me monitorimin. Nga raporti vjetor thuhet se vërehen filtrime të vogla në shpatullën e majtë të digës si dhe në disa fuga në sallën e makinerive –këto filtrime duhet të janë në vrojtim të vazhdueshëm, si dhe të shikohet mundësia për eleminimin e tyre.

Po ashtu të kryhen matjet gjeodezike dhe sizmike në aparaturat e vëndosura si dhe të bëhet intepretimi i tyre duke bashkëpunuar me KESH-in ose ndonjë kompani tjetër të specializuar në këtë fushë.

## DIGA MBI LUMIN BISTRICE

Aktualisht mbi lumin Bistricë është në shfrytëzim diga e HEC Bistrica nr.1. Që prej vitit 2013, kjo digë administrohet nga kompania private KURUM. Nga Raporti vjetor i paraqitur nga shfrytëzuesi i kësaj digë rezulton se kjo digë është brenda kushteve normale të punës.

## H/C Ashtes

H/C i Ashtës administrohet nga shoqëria Energji Ashta.

Diga dhe gjithë strukturat e hidrocentralit janë në gjëndje të mirë. Problem janë strukturat ndërtimore ekzistuese si Ura e Spatharës, ura egzistuese e veprës së marrjes, diga e Mqedës porta e kanalit të Mqedës dhe kanalit të Deas të cilat janë të lidhura me këtë hidrocentral dhe i shërbejnë atij, por sipas koncesionit ato janë nën përgjegjësinë e Ministrisë se Bujqësisë. Është detyre e palëve të bashkëpunojnë për mirëmbajtjen.

## Diga e H/C Banjë.

KKDM që nga muaji gusht 2015, ka ndjekur vazhdimesh plotësimin e procedurave ligjore për krijimin e kushteve të mbushjes për herë të parë dhe vënien nën ngarkesë të digës së H/C të Banjës. Kontrolli i punimeve si dhe i procedurave për mbushjen, krijuan mundësinë për dhënien nga KKDM të autorizimit për mbushjen për herë të parë të rezervuarit të Banjës. Mbushja e tij filloi në 22 prill 2016. Për këtë objekt do ketë një rëndësi të vecantë në të ardhmen, bashkëpunimi i Devoll Hydropoëer dhe i

MBZHRAU lindhur me kontrollin dhe gadishmérinë e argjinaturave të lumiit Seman në përballimin e shkarkimeve që do të jenë nga H/C Banjë.

#### IV. Konkluzione të përgjithshme.

KKDM vëren se problemet e sigurisë se digave vazhdojnë të jenë në gjëndje jo të kërkuar nga standartet teknike e ligjore. Si dhe kemi përmendur i kemi paraqitur organeve përkatëse dhe propozime më të detajuara për një program kombëtar për kontrollin e sigurisë së digave në vend. Kjo në mënyrë të vecantë për atë numur të madh digash të cilat edhe nuk përdoren aktualisht dhe që me parë kanë qenë në administrim të MBZHRAU-së dhe tani kanë kaluar në administrim të pushtetit vendor. Krahas realizimit në se do jetë e mundur të këtij programi i cili do shërbeje për njohjen tekniko ekonomike të gjendjes së digave, do duhet të punohet dhe në drejtim të përmirësimit të aspekteve ligjore si dhe të plotësimit me strukturat e nevojshme. Këto struktura do duhet të rishikohen në nivel lokal, nivel të dytë dhe në vetë Sekretariatin Kombetar të Digave e në KKDM. Jemi të mendimit se njohja dhe miratimi i programit kombëtar të propozuar do rrissë sensibilitetin dhe do ndihmojë në ristrukturim e plotësim të strukturave të nevojshme.

Edhe nëse do flasim për legjislacionin aktual në fuqi, ligji 8681 dt. 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin e mirëmbajtjen e digave e dambave” (neni 4), na rezulton se nuk kemi :

- Këshill Teknik të Përhershëm të Digave si organ këshillimor. Kemi një Këshill Teknik jo të përhershëm me numër të kufizuar dhe pa pagesë.
- Inpektoriati Teknik i Digave si organ kontrolli në ndërtim por mbi të gjitha në shfrytëzim, nuk ekziston.
- Sekretariati Kombetar i Digave të Mëdha si zyrë ekzekutive dhe që duhet të mbajë relacionet institucionale, ka vetem një specialist/arkiviste.

Me strukturat aktuale dhe në mungesë dhe të një institucioni studimor dhe unifikues për praktikat në funksion të interesave të vendit, i cili do të ndihmonte dhe me pasqyrimin e punës dhe sistemeve të veprave të ndërtuara, si dhe në sugjerimin e normave tekniko ekonomike, gjykojme se siguria dhe kontrolli i digave dhe për një kohë të konsiderueshme do shoqërohet me probleme që do përsiten herë mbas here.

Në programin e sipërpërmendur shtrohet nevoja dhe e krijimit të Institutit Kombëtar të Ujit. Ky institutë jo vetëm që do marrë në dorë një pasuri të madhe kombëtare dhe do i shërbejë administratës publike jo vetëm për miratimin e projektve të ndryshme, caktimin e normave tekniko ekonomike në ndërtimin e veprave që do përdoren për shfrytëzimin e ujit por do jetë dhe një vlerësues i vazhdueshëm i problemeve teknike që do lidhen me sigurinë e këtyre veprave në përgjithësi dhe të digave në vecanti. Materiali i është dorzuar Këshillit Kombëtar të Ujit dhe po ndiqen procedurat e shqyrtimit të tij.

Mendojme se kemi paraqitur në mënyrë të përbledhur problematikën e digave në vend.

Me respekt

Inxh. Maksim Muçi

